



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C (2) (turqisht)

Ngarkesa: 6 ECTS, 60 orë seminare

Viti / Semestri: Viti I , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Komunikim në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik tri-gjuhësh”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin C1 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore;

- 1.Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimit në gjuhën turke.
- 2.Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave.
- 3.Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.

Rezultate të pritshme:

- 1.Zhvillimi i kompetencave të avancuara gjuhësore në turqisht, duke përfshirë të kuptuarit, shkrimin dhe shprehjen në mënyrë të qartë dhe të rrjedhshme në kontekste akademike dhe profesionale.
- 2.Aftësimi në përdorimin e fjalorit të avancuar, përmes analizës së kontekstit, përdorimit të sinonimeve, antonimeve, parashtesave/prapashtesave dhe përkufizimeve të sakta.
- 3.Përvetësimi i aftësive për të strukturuar dhe prezantuar materiale në gjuhën turke, duke përdorur strategji të përshtatshme komunikimi dhe të lexuarit kritik për të nxjerrë kuptime dhe për të formuluar përfundime të arsyetuara.